



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1982/ 7 prot.

Datë 26.08.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 1045 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                |            |
|----------------|------------|
| Gjergj Mersini | Nënkryetar |
| Donika Daci    | Anëtar     |
| Edvin Simo     | Anëtar     |
| Nertil Kanina  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 26.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” shpk në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, *Mallra*, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” ShPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Adi Professional ” shpk me K22113002I, *Adresa: Rr. “Butrinti”, nr.9, Kashar, Tiranë.*

Operatori ekonomik “TETRA” shpk me K72017027P, *Adresa: Rr. “Gjin Bue Shpata”, P.2/1, Ap.2, Nj.Ad. nr.5, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë.  
*Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rr.Osman Haxhiu, Vlorë.*

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “PC STORE” shpk me NIPT 01606034A  
*Adresa: “Rruga e Dibrës”, Vila nr.153, kt. I, Tiranë.*

Operatori ekonomik “TETRA” shpk me K72017027P, *Adresa: Rr. “Gjin Bue Shpata”, P.2/1, Ap.2, Nj.Ad. nr.5, Tiranë.*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:****I***Vlerësimi Paraparak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraparak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 24.04.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2026.

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 03.06.2026 ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Me datë 15.06.2026 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës si më poshtë vijon:

|   | Operatorët ekonomikë                    | Vlerat e ofertave | Vlerësimi   |
|---|-----------------------------------------|-------------------|-------------|
| 1 | PC STORE SHPK                           | 10,721,000.25     | Kualifikuar |
| 2 | TETRA SHPK                              | 10,742,500        | Kualifikuar |
| 3 | Adi Professional SHPK                   | 11,486,500        | Kualifikuar |
| 4 | Martini Konstruksion & Real Estate SHPK | 14,294,666        | Kualifikuar |

II.3. Nga verifikimet e kryera në SPE, Autoriteti Kontraktor më datë **16.06.2026** ka publikuar Njoftim fituesi paraprak.

II.4. Nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6849, datë 19.06.2026 dhe me Nr. 1982/2026 Prot., datë 19.06.2026 e operatorit ekonomik “TETRA” shpk, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, *Mallra* me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me, vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” shpk në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.4.1. Bazuar në nenin 112 pika pika 4, gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ) si dhe formularin e publikimit nr. 1982/2 prot., datë 22.06.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.5. Me shkresën ardhur në sistem, protokolluar me tonën me nr. 1982/1, datë 22.06.2026, si edhe shkresa ardhur me shërbim postar nr.12451 prot., datë 22.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1982/4, datë 25.06.2026, me objekt informacion mbi Vendimin Nr. 12451 prot., datë 22.06.2026 të KSHA-së.

Referuar vendimit AK ka marrë në shqyrtim ankesën dhe ka vendosur mospranim të pretendimeve të ngritura nga ankimuesi.

II.6. Në referim të nenit **113 të ligjit 162/2020** “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, me shkresën ardhur në sistem protokolluar me tonën me nr.1982/3, datë 24.06.2026, operatori ekonomik ankimues i interesuar “PC STORE” shpk ka përcjellë Formularin e Paraqitjes së Argumentave në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “TETRA” shpk.

II.7. Nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6856, datë 22.06.2026 dhe me Nr. 1991/2026 Prot., datë 22.06.2026 e operatorit ekonomik “Adi Professional” shpk, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, *Mallra* me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me, vendimmarrjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “PC STORE” shpk dhe operatori ekonomik “TETRA” shpk në procedurën e sipërcituar të prokurimit.

II.7.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin e publikimit nr. 1991/1 prot., datë 23.06.2026, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë.

II.8. Me shkresën shkresa ardhur në sistem nr. 12536/1 prot., datë 24.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1991/2, datë 24.06.2026, si edhe ardhur me shërbim postar me nr. 12536/1 prot., datë 24.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1991/5, datë 30.06.2026, me objekt Vendim i KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Adi Professional” shp, autoriteti kontraktor ka përcjellë Vendimit e KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës duke vendosur mospranim të pretendimeve të ngritura.

II.9. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me shkresën ardhur në sistem protokolluar me tonën me nr.1991/3, datë 29.06.2026, operatori ekonomik ankimues “Adi Professional” shpk ka përcjellë Formularin e paraqitjes së argumentave në lidhje me Vendimin e KSHA-së mbi trajtimin e ankesës së tij.

II.10. Në referim të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me shkresën ardhur në sistem protokolluar me tonën me nr.1991/4, datë 29.06.2026, operatori ekonomik i interesuar “PC STORE” shpk ka përcjellë Formularin e Paraqitjes së Argumentave, në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Adi Professional” shpk.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Adi Professional” shpk për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” Shpk me argumente si vijon:

I. Në gjykimin tonë si operator që cenohemi KVO nuk ka vlerësuar në përputhje me parashikimet ligjore ofertën e paraqitur nga OE TETRA Sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt Sistem i parkimit për Vlora Parking , duke sjellë në këtë mënyrë kualifikimin e padrejtë të ofertës së këtij operatori. Më poshtë po ju paraqesim kundërshtimet që lidhen vetëm me dokumentacionin e paraqitur ose qe duhej paraqitur nga OE TETRA në SPE, pasi ky operator duke qenë se është klasifikuar i dyti, nuk ka dorëzuar dokumentacionin që provon vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8).

**Në pikën 2.2.3 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit,** AK ka përcaktuar se operatorët ekonomik duhet provojnë faktin se kanë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga **Pushteti Vendor për vitin 2026 të MATURUARA**, ku të përfshihet kasti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore , i ndryshuar.

Në lidhje me mënyrën e përmbushjes së kësaj pike, sqarojmë se AK Bashkia Vlorë, nuk ka përcaktuar që kjo pikë do të konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sikurse plotësohen kriteret e tjera të përgjithshme të kualifikimit në fazën e dorëzimit në SPE të ofertës. Mungesa e një parashikimi të tillë, nënkupton se ofertuesit në këtë procedurë prokurimi, **DUHET TË NGARKONIN NË SPE DOKUMENTIN (VËRTETIMIN) E LËSHUAR NGA ORGANET E QEVERISJES VENDORE KU USHTROJNË AKTIVITETIN, NËPËRMJET TË CILIT TË VËRTETONIN SE KANË LIKUJDUAR TË GJITHA DETYRIMET VENDORE TË MATURUARA.** Në territorin e Bashkisë Tiranë, ku ushtron aktivitetin edhe operatori TETRA, detyrimet vendore si dhe afatet e maturimit për këto detyrime, përcaktohen nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar si dhe nga Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 158, datë 26.12.2019 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës , të ndryshuar Vendimi nr. 158, datë 26.12.2019 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës i ndryshuar me VKB-në nr. 59, datë 24.07.2025, në nenin 42, pika 4 përcakton si vijon Për kategorinë II. Biznesi detyrimi paguhet brenda datës 31 Maj. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 31 Maj është 15 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit . Referuar këtij parashikimi rezulton se detyrimet që kanë të bëjnë me taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Tiranë (me përjashtim të kështit 1 dhe 2 të taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore që maturohen në datata 20 Prill dhe 30 Qershor), maturohen në datën 31 Maj të çdo viti. Në këtë kuptim, subjektet zhvillojnë aktivitet tregtar në territorin administrativ të Bashkisë Tiranë, për të vërtetuar se kanë likuajduar të gjitha detyrimet vendore të MATURUARA, duhet të pajisen me vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë (DPTTV), i cili duhet të ketë datë lëshimi mbas datës 1 Qershor e në vijim. Cdo vërtetim i lëshuar para kësaj date vërteton/konfirmon vetëm likuidimin e detyrimeve vendore të vitit paraardhës (2025) si dhe kështin 1 të taksës së ndërtesës, truallit dhe tokës bujqësore, i cili maturohet në datën 20 Prill. Nisur ka sa kemi shpjeguar më lartë, ne kemi bindjen se operatori **TETRA Sh.p.k** nuk ka përmbushur pikën 2.2.3 të kriterëve të kualifikimit për shkak se: (a) Nuk ka paraqitur në SPE vërtetimin e likuidimit të detyrimeve vendore të lëshuar nga Bashkia Tiranë sikurse ka përcaktuar Autoriteti Kontrator Bashkia Vlorë, **në pikën 2.3.3 të kriterëve të vecanta të kualifikimit.** (b) Vërtetimi i likuidimit të detyrimeve vendore edhe nese është paraqitur nga operatori TETRA në SPE, nuk vërteton gjendjen faktike të tij në momentin e ofertimit, përkatësisht në datën 03.06.2026, pasi ky vërtetim është lëshuar para datës 31 Maj 2026 dhe si rrjedhojë nuk përmban informacion në lidhje likuidimin e detyrimeve vendore të MATURUARA, pasi këto detyrime referuar nenit 42, pika 4, të Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 158, datë 26.12.2019 Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës i ndryshuar me VKB-në nr. 59, datë 24.07.2025, **janë MATURUAR në datën 31 Maj 2026.**

III.1.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST, Shtojcën 7, Kriteret e veçanta të kualifikimit, **2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të maturuara, ku të përfshihet kasti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik “TETRA” shpk, në përmbushje të kriterit për kualifikim 2.2.3 të sipërcituar ka paraqitur dokumentet emërtuar:



Vertetim\_likuidimi\_te\_Taksave\_dhe\_Tarifave\_Vendore\_Bashkia\_Tirane TETRA.pdf

Në brendi të të cilit gjendet: dokumenti Vërtetim për Likuidimin e Detyrimeve Vendore, Lëshuar nga Drejtoria e përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Tetra ShPK ka likuiduar detyrimet vendore.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.4. Në nenin 77, pika 1 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.5. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret, nga verifikimi në SPE vihet re, se në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik TETRA shpk, ka dorëzuar dokumentin sipërcituar, i cili rezulton i rregullt, lëshuar nga institucioni përkatës, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, në kohën e duhur përpara hapjes së ofertave, si edhe nga përmbajtja e tij që vërteton se *...[...] subjekti TETRA ka likujduar detyrimet vendore sipas parashikimeve ligjore. [...]*

Në përfundim të analizës dhe dokumentacionit të dosjes, Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimues "TETRA" ShPK përmbush kriterin më sipër pika 2.2.3 me dokumentin e paraqitur në këtë procedurë prokurimi.

Përsa i përket pretendimeve të ankimuesit *...Tetra shpk nuk ka dorezuar dokumentacion provuese të ofertës për OE ekonomik të renditur në vend të dytë i kualifikuar....*, Komisioni gjykon se pretendimet e ankimuesit vlejné për operatorin ekonomik fitues jo për operatorët e tjerë të kualifikuar, të cilët përmbushin kriteret e përgjithshme për kualifikim me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si provë paraprake në përmbushje të kriterëve të përgjithme kualifikues.

Përsa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Adi Professional" shpk për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "TETRA" Shpk me argumente si vijon:

*Në pikën 2.3.5 të Kapcitetit teknik, pjesë e kriterëve të vecanta të kualifikimit, përcaktuar Operatori Ekonomik duhet kete dhe te paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si me poshte: a. Certifikate: EN ISO 9001:2015-Sistemi i Menaxhimit të cilesisë; ose ekuivalente Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt- marrëveshjes.*

Nga verifikimi i ekstraktit tregtar të TETRA Sh.p.k, rezulton se ky operator ka një objekt relativisht të gjerë aktivitetit të deklaruar. Konkretisht, **objekti i aktivitetit të operatorit TETRA është si vijon:**

**Krijim, zbatim, integrim te sistemeve te Informacionit dhe te Programeve Kompjuterike. Nderitim i sistemeve te komunikimit ne rrjete, import export tregti te pajisjeve dhe programeve ne fushen e teknologjise se Informacionit, si dhe te sigurise fizike apo kontrolli te aksesit, perfshire ato me perdorim te dyfishte. Konsulenca dhe mirembajtjeve te tyre. Krijim, organizim kurse profesionale, trajnime etj. Operim, zbatim, dhenie me qera e sistemeve dhe e pajisjeve te ndryshme informatike qe sherbejne per administrimin e operacioneve te ndermarrjeve, shitje ne/ internet, sisteme te parkimit, sisteme biletarie elektronike dhe te ngjashme, sisteme dhe pajisje per karikimin e automjeteve elektrike. Import-eksport dhe tregtim i pajisjeve karikues per automjete elektrike. Ofrim konsulence dhe sherbimi per projektim, instalim dhe mirembajtje te sistemeve te karikimit te automjeteve elektrike.**

Nisur nga kompleksiteti i objektit të aktivitetit që ka ky operator, **KEMI DYSHIME TË ARSYESHME SE CERTIFIKATA E MENAXHIMIT TË CILËSISË ISO 9001 E DORËZUAR NGA TETRA SH.P.K, NUK PËRMBAN OBJEKTIN E PROKURIMIT TË PLOTË,** që në rastin konkret është Sistem i Parkimit për Vlora Parking Nisur nga sa më lartë, Certifikata ISO 9001-2015 e paraqitur nga operatori TETRA, nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 2.3.5 të kriterëve të kualifikimit të përcaktuara në DST dhe si rrjedhojë oferta e paraqitur nuk është e vlefshme në kuptim të pikës 3 të nenit 92 të LPP dhe pikës 2 të nenit 82 të RPP

III. 2.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST, Shtojcën 7, Kriteret e veçanta të kualifikimit, **2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Kriteri 2.3.5.** Operatori Ekonomik duhet ketë dhe të paraqesë certifikatat e konformitetit me Standartet ISO si më poshtë:

a. Certifikatë: EN –ISO 9001:2015-Sistemi i Menaxhimit të cilësisë; ose ekuivalente

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili operator ekonomik duhet të disponojë certifikatat ISO sipas zërave/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt- marrëveshjes.

**Argumentimi:** Vendosja e certifikatave të kërkuara më sipër është bërë mbështetur në specifikimet teknike dhe në varësi të zërave përkatës të preventivit. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të jenë të certifikuar nga organizata kombëtare/ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit, sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi to. Këto standarde aplikohen për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar, pavarësisht nëse janë prodhuese apo importuese, madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë.

*Furnizimi dhe vendosje të pajisjeve*

| SISTEMI PARKIMIT NE SHESHE |                                                                           |
|----------------------------|---------------------------------------------------------------------------|
| Nr.                        | Përshkrimi i mallit                                                       |
| 1.                         | Pajisje për lëshimin dhe matjen e kohës e parkimit, me ekran dhe aksesore |
| 2.                         | Pajisje për kontrollin e pagesës së parkimit me display dhe aksesore      |

|     |                                                                                             |
|-----|---------------------------------------------------------------------------------------------|
| 3.  | Pajisje bariere për kontrollin e lëvizjes së mjeteve (të komandueshme nga sistemi parkimit) |
| 4.  | Pajisje për leximin e biletave                                                              |
| 5.  | Software qendror për menaxhimin e qendëruar të sistemit të parkimit                         |
| 6.  | Pajisje kompjuter për instalimin e programit, monitor                                       |
| 7.  | Pajisje kioske për instalimin e sistemit si dhe për pikën e pagesës së parkimit             |
| 8.  | Kamera të jashtme                                                                           |
| 9.  | Kamera e brendshme me audio                                                                 |
| 10. | DVR me 16 kanale                                                                            |
| 11. | DVR me 12 kanale                                                                            |
| 12. | Integrim me shërbim fiskalizimi                                                             |
| 13. | Letër parkimi, komatibël me sistemin e parkimit                                             |
| 14. | Karta RFID                                                                                  |
| 15. | Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi                      |
| 16. | Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi                      |
| 17. | Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi                      |
| 18. | Instalim, konfigurim së bashku me aksesore të tjerë instalativ parkimi                      |
| 19. | Ndarëse Dekorative Urbane Metalike e përkulshme 720 mm*705mm (H*Ë)                          |
| 20. | Ndarëse Dekorative Urbane Metalike 1020mm*1105mm (H*Ë)                                      |
| 21. | Sistem i qendëruar i menaxhimit për raportim dhe analizim                                   |

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik “TETRA” shpk, në përmbushje të kriterit për kualifikim 2.3.5 të sipërcituar ka paraqitur dokumentin



emërtuar: **Certifikate\_EN\_ISO\_9001 TETRA.pdf** në brendi të të cilit gjendet:  
 Certificate nga EuroCert për kompaninë TETRA SH.P.K që zbaton Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë sipas standartit: EN ISO 9001:2015. E vlefshme deri me datë 18.03.2028.

Dokumenti i noterizuar.

III.2.3. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësive të operatorëve për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë për mallrat/shërbimet objekt prokurimi.

Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatës së konformitetit me Standartet ISO si **Certifikatë: EN –ISO 9001:2015-Sistemi i Menaxhimit të cilësisë; ose ekuivalente.**

Referuar SPE-së, dokumenteve të ofertës së operatorit “TETRA” Shpk, në përmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit, **kriterit 2.3.5**, shoqëria “TETRA” Shpk ka paraqitur Certifikatën ISO

9001:2015, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, lëshuar nga EUROCERT datë e certifikimit 19.03.2019 e vlefshme deri në 18.03.2028 i perkthyer dhe i noterizuar.

Komisioni konstaton se dokumenti vërteton se kompania "TETRA" shpk zbaton një sistem Menaxhimi të Cilësisë sipas Standardit: EN ISO 9001:2015 për fushën e mëposhtme të certifikimit:

"Projektim, zhvillim, implementim, integrim, mbështetje e infrastrukturës së TI-së dhe sistemeve të aplikacioneve.

Projektim, organizim dhe ofrim i shërbimeve të teknologjisë së informacionit të menaxhuara ose të ofruara në ambientet e palëve të treta, duke u përqendruar në qendrën e të dhënave, rrjetëzimin, sigurinë, komunikim dhe bashkëpunim të unifikuar, trajnim profesional, menaxhim të ngjarjeve dhe logove të sigurisë, aplikacione financiare SAAS në remin privat dhe hibrid, shërbime mbështetjeje për ankesa ITIL, mur fireëall i bazuar në REM, shërbime sigurie të Web-it dhe postës.

Shitje dhe mbështetje e licencave të pajisjeve të TI-së dhe të programeve.

Projektim, implementim dhe mbështetje e automatizimit të procesit, sigurisë së sistemit dhe kontrollit të sistemeve."

Referuar ankesës së operatorit ekonomik me pretendimet se:[...] Kemi dyshime të arsyeshme se certifikata e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 e dorëzuar nga TETRA Sh.p.k, nuk përmban objektin e prokurimit të plotë...[...]. Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e dosjes administrative dhe vëren se, subjekti "TETRA" Shpk me certifikatën sipërcituar mbi zbatim të Sistemit të Menaxhimi të Cilësisë sipas Standardit: EN ISO 9001:2015 për fushën e mëposhtme të certifikimit: mder te tjera si vijon:

Projektim, zhvillim, implementim, integrim, mbështetje e infrastrukturës së TI-së dhe sistemeve të aplikacioneve.

Projektim, organizim dhe ofrim i shërbimeve të teknologjisë së informacionit të menaxhuara ose të ofruara në ambientet e palëve të treta

Projektim, implementim dhe mbështetje e automatizimit të procesit, sigurisë së sistemit dhe kontrollit të sistemeve.

Komisioni nga analizimi i dokumenteve sipërcituar si edhe referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, përshkrimin e mallrave të procedurës së prokurimit, Specifikimi i Materialeve dhe Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to, gjykon se operatori ekonomik "TETRA" Shpk, me dokumentacionin e paraqitur, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7, pika 2.3.5, "Kapaciteti teknik", në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, (cituar e listuar më sipër në pikën III.2.1) pasi vërteton se është i certifikuar sipas standardit EN ISO 9001:2015 ku fusha e certifikimit është në përputhje me objektin e prokurimit në përmbushje të shërbimit objekt-prokurimi në tërësinë e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara e listuara në DST. Pretendimet e ankimuesit bazohen mbi dyshime dhe hamendësi pa baza e fakte konkrete.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "Adi Professional" Shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik "PC STORE" shpk, Komisioni gjykon të mos i marrë në shqyrtim pasi bazuar në arsyetimin sipërcituar, mbi mospranimin e pretendimeve të ankimuesit për skualifikim

të operatorit ekonomik “TETRA” Shpk, ku gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë duke mbetur i kualifikuar dhe ankimuesi “Adi Professional” Shpk nuk do të mundë të fitojë kontratën përse kohë në renditje të operatorëve të kualifikuar qëndron në vend të tretë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “TETRA” Shpk për skualifikim të operatorit ekonomik “PC STORE” Shpk argumentuar si vijon:

*Mendojmë se operatori ekonomik “PC STORE” ShPK nuk ka plotësuar kriterin kualifikuese 2.3.2 të kriterëve të vecanta për kualifikim të specifikisht: Mbi përvoja të mëparshme të ngjashme, pasi njohim tregun dhe nga informacionet ky OE nuk e plotëson këtë kriter kualifikimi në procedurën e prokurimit me objekt Sistem i Parkimit për Vlora Parking ku cdo kontrate duhet të jetë e ngjashme në këtë fushë.*

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Dokumentet e tenderit, shtojcën 7, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

Kriterin **2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, **të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes** së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime të lëshuara nga një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **ose/dhe fatura tatimore të shitjes, dhe të deklaruara në organet tatimore** të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.2. Në nenin Neni 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore

*e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.4.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se:

Operatori ekonomik “PC STORE” shpk, në përmbushje të kriterit Kriteri 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, **të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me **sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime të lëshuara nga një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës **ose/dhe fatura tatimore të shitjes, dhe të deklaruara në organet tatimore** të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara, Operatori ekonomik “PC STORE” shpk ka dorëzuar dokumente.



\_2\_3\_1\_KontFSHZH\_Stacion\_Smart\_per\_Bashk\_ElbFatur.pdf

1. Kontrate Mallra, me nr. 2416 prot., datë 29.05.2025, me objekt “Stacion Autobuzi SMART”, Lidhur midis Operatorit “PC STORE” shpk dhe Autoritetit Kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me vlerë XX,XXX,XXX Lekë pa TVSH. Me mallra në referim të **Faturës elektronike nr.XXXX /2025, datë 22.12.2025.**



\_2\_3\_1\_Kontrate\_Spitali\_Fier.pdf

2. Kontratë Shitblerje, me nr. 715 prot, datë 23.05.2023 me objekt “Blerje Trau automatik” Lidhur midis Operatorit “PC STORE” shpk dhe Autoritetit Kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier, me vlerë X,XXX,XXX Lekë pa TVSH. Me mallra në referim të **Faturës elektronike nr.XXXXX /2023, datë 22.06.2023.**

Vërtetim për realizimin e kontratës nr. 190/1 prot., datë 09.02.2024, lëshuar nga AK.

III.4.4. Operatori ekonomik “PC STORE” shpk, në përmbushje të kriterit 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, **të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruar në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ka dorëzuar dokumente .



\_2\_3\_1\_FV\_Sistemi\_PLAZA\_TIRANA.pdf

Faturë elektronike **nr. XXX/2026, datë 15.01.2026.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës “The Plaza” Tirana.

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 29.01.2026.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës “The Plaza” Tirana.

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 29.08.2025.** shitës “PC STORE” ShPK–Blerës ”The Plaza” Tirana,

Faturë elektronike **nr. XXX/2026, date 30.01.2026.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës Ramiz Ismajlgeci,

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 26.09.2025.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës Ramiz Ismajlgeci,

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 09.10.2025.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës Ramiz Ismajlgeci,

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 31.10.2025.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës Ramiz Ismajlgeci,

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 27.11.2025.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës Ramiz Ismajlgeci,

Faturë elektronike **nr. XXXX /2025, date 26.12.2025.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës Ramiz Ismajlgeci,



\_2\_3\_1\_6096\_2025\_QUANTX\_SISTEM\_PARKIMI.pdf

Faturë elektronike **nr. XXXX/2025, date 09.10.2025.** shitës “PC STORE” shpk –Blerës “QuantX IT Solutions” shpk

III.4.5. Referuar Legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, përvojën e duhur të nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton

kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderitpërsa kohë i kanë pranuar ato.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, **të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes** së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Në përmbushje të kriterit 2.3.2 pikat a) dhe b) Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës në SPE dorëzuar nga OE "PC STORE" shpk konstaton se, ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin mbi kontrata të ngjashme, cituar në pikën III.4.5. të këtij vendimi. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të faturës të shitjes, konstaton se kontrata dhe fatura shitjeje me artikuj/shërbime të ngjashëm me objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit, duke përmbushin kriterin edhe tejkaluar vlerën 30% të fondit limit prej 14,294,667 L X 30% =4,288,399.<sup>8</sup> L pa Tvsh, konkretisht ka realizuar furnizime të ngjashme si me:

Kontrata dhe fatura të rregullta shitje për instirucione/ente shtetërore në përmbushje **të Kriterin 2.3.3. pika a)** si dhe realizuar me Fatura Tatimore shitje, për subjekte private në përputhje me **Kriterin 2.3.2. pika b)**

Përsa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori "PC STORE" ShPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE, ka plotësuar kriterin 2.3.3. /a), /b) të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa i përket dëshmive të realizimit të shërbimeve të ngjashme.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.5. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "TETRA" Shpk mbi skualifikim të operatorit ekonomik "PC STORE" shpk argumentuar si vijon:

*Për sa i perket specifikimeve teknike te publikuara nga AK, ato perbejne nje pjese shume te rendesishme te procedures pasi ndikojne drejteperdrejte ne funksionimin ne vend te gjithe zgjidhjeve te kerkuara.*

*Nga verifikimi i specifikimeve teknike dhe katalogeve te pajisjeve qe operatori ekonomik PC STORE tregon dhe qe jane te publikuar ne rrjet si informacion publik verejme se pajisjet e ofertuara nuk plotesojne specifikimet teknike te kerkuara nga AK. Me poshte:*

**Mosplotesim te Specifikimeve Teknike per artikujt 1,3,5 dhe 21,;**

|                                                                                                      |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Pajisje per leshimin dhe matjen e kohes e parkimit, me ekran dhe aksesore</b>                     |
| <b>Pajisje bariere per kontrollin e levizjes se mjeteve (te komandueshme nga sistemi i parkimit)</b> |
| <b>Software qendror per menaxhimin e qenderzuar te sistemit te parkimit</b>                          |
| <b>Sistem i qenderzuar i menaxhimit per raportim dhe analizim</b>                                    |

III.5.1. Komisioni mori në shqyrtim DST nga verifikimi i të cilave, rezultoi, se në shtojcën 5, Formulari i Specifikimeve teknike si edhe Shtojcës 7, Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit në të cilët Ak ka përcaktuar dokumentet të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë, Komisioni konstatoi, se nuk evidentohet të jetë përcaktuar ndonjë kërkesë/kriter për paraqitje nga ofertuesit ***katalogë/broshurat për pajisjeve***, madje në asnjë vend të dokumenteve të tenderit objekt shqyrtimi nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë e tillë ndaj ***paraqitja apo mosparaqitja e broshurave të pajisjeve***, pretenduar nga ankimuesi, nuk mund të përbejë shkak për kualifikimin/skualifikimin e një operatori ekonomik.

Akoma më tej në Formularin e ankesës operatori ekonomik “TETRA” shpk, ka cituar mbi ***[...]kataloge të pajisjeve që operatori ekonomik PC STORE shpk tregon dhe që janë të publikuar në rrjet si informacion publik...*** duke rezultuar pretendim që nuk ka lidhje me procedurën e prokurimit dhe dokumentacionin e saj, argument i hamendësuar dhe i pabazuar në fakte konkrete.

Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar ***paraqitja e kataloge/broshura për pajisjet objekt prokurimi***, rrjedhimisht, operatori ekonomik nuk mund të paraqesë dokumente të pakërkuara, por edhe autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij, në dokumentet e tenderit.

Në mënyrë të qartë Ligji “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon: [...] Autoritetet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga nenin 3 i *lex specialis*, “Parime të përgjithshme” që të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe me transparencë e në mënyrë proporcionale të kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues janë ngritur mbi kërkesa/kritere të pa kërkuara në DST.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

*e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “TETRA” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 03.06.2026.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Adi Professional” ShPK për procedurën e prokurimit, sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “TETRA” shpk.
5. Ngarkohet zyra e financës që të derdhë në buxhetin e shtetit tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik “Adi Professional” shpk.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Donika Daci**

**Anëtar**  
**Edvin Simo**

**Anëtar**  
**Nertil Kanina**

**Nënkryetar**  
**Gjergj Mersini**



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik  
Date: 2026/08/27 16:36:47 +02'00'  
3b07c362c2374641bb9877e8820faff320260827163642  
81020

Digitally signed by  
Gjergj MERSINI  
Date: 2026.08.28  
11:16:30